



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 prill 2016  
Nr. ref.:RK920/16

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI110/15**

Parashtrues

**Bedrije Rrahmani**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në  
Prishtinë, E. nr. 752/07, të 31 majit 2007**

### **GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Bedrije Rrahmani, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 752/07, i 31 majit 2007.
3. Ky aktvendim i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 24 prill 2015.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet që është shkelur neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 19 gusht 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 shtator 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
8. Më 25 shtator 2015, Gjykata e informoi parashtruesen dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Me këtë njoftim, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës dhe Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojnë kopjen e fletëkthesës që tregon datën e pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 752/07, të 31 majit 2007.
9. Më 1 tetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi informacionin e kërkuar. Në përgjigje të Gjykatës Themelore shihet se më 24 prill 2015, parashtruesja e kërkesës e ka pranuar Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
10. Më 8 mars 2016, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

11. Parashtruesja e kërkesës ishte në marrëdhënie pune nga viti 2003 deri më 30 dhjetor 2005, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS) në pozitë infermiere përgjegjëse-terapeute medicinale.

12. Më 30 dhjetor 2005, Sekretari i MPMS [Aktvendimi nr. 6999], e ka sistematizuar parashtruesen e kërkesës në pozitë motër medicinale, përkatësisht në një pozitë më të ulët nga ajo që e ka pasur më parë.
13. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Komisionin për Ankesa pranë MPMS-së kundër këtij Aktvendimi.
14. Më 28 shkurt 2006, Komisioni për Ankesa i MPMS-së, me Vendimin nr. 25/06 e refuzoi ankesën e parashtrueses dhe konfirmoi vendimin e Sekretarit të MPMS-së.
15. Më 22 mars 2006, parashtruesja e kërkesës, kundër Vendimit të Komisionit për Ankesa pranë MPMS-së, parashtrroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK).
16. Më 24 prill 2006, KPMK-ja, me Vendimin A, 02, 38/2006, e aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës, e prishi Aktvendimin e Sekretarit të MPMS-së dhe Vendimin e Komisionit për Ankesa pranë MPMS-së si dhe e urdhëroi MPMS-në ta kthej parashtruesen në pozicionin e mëparshëm.
17. Më 17 maj 2007, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatën Komunale në Prishtinë propozim për përmbarimin e vendimit të KPMK-së.
18. Më 31 maj 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 752/07, e lejoi përmbarimin e vendimit të KPMK-së, dhe kështu edhe kthimin e parashtrueses në pozicionin e mëparshëm.
19. Më 23 shkurt 2009, MPMS-ja dhe parashtruesja e kërkesës lidhën kontratë me të cilën parashtruesja u sistematizua në një pozicion të ri i cili ishte ekuivalent me pozitën e mëparshme dhe lartësinë e pagës.
20. Më 15 korrik 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë i dërgoi MPMS-së një urdhër për dërgimin e të dhënave për përmbarimin e Aktvendimit C. nr. 752/07 të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
21. Më 18 gusht 2011, MPMS-ja dërgoi në Gjykatën Komunale në Prishtinë dokumentacionin e kompletuar lidhur me mënyrën e përmbarimit të Aktvendimit C. nr. 752/07 të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Në njoftimin e saj, MPMS-ja, ndër të tjera, theksoi:
 

*“Bazuar në dosjen personale të punëtores Bedrije Rrahmani, ju informojmë së aktvendimi i G.J.K. në Prishtinë është ekzekutuar dhe punëtores i është ndërruar pozita nga Motër medicinale në Terapeut/e Shëndetsor për Edukim dhe Rehabilitim në Shtëpinë e Personave të Moshuar nga data 01.02.2009”.*
22. Më 10 prill 2015, parashtruesja dorëzoi kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë për pranimin e Aktvendimit C. nr. 752/07, të 31 majit 2007.
23. Më 24 prill 2015, parashtruesja e kërkesës e ka pranuar Aktvendimin C. nr. 752/07 e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Parashtruesja e kërkesës konsideron se MPMS-ja, me moszbatimin e Vendimit të KPMK-së, A, 02, 38/2006, dhe Aktvendimit C. nr. 752/07, të Gjykatës Komunale të Prishtinës ia ka shkelur të drejtën e saj të garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

## **Pranueshmëria e kërkesës**

25. Për të qenë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ajo i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, parashikon:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

27. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit përcakton:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

28. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(1) *“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*[...]*

*d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

(2) *Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.*

29. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës është e kënaqur me Aktvendimin C. nr. 752/07 e Gjykatës Komunale në Prishtinë, por nuk është e kënaqur me mënyrën me të cilën ishte zbatuar ky Aktvendim, përkatësisht me pozitën në të cilën MPMS-ja e kishte sistematizuar pas zbatimit të Aktvendimit C. nr. 752/07.

30. Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesja e kërkesës e kishte ndërtuar ankesën e saj kushtetuese mbi shkeljen e pretenduar të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

31. Gjykata thekson se e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit nga neni 49 i Kushtetutës është subjekt i mbrojtjes në sistemin kushtetues të Kosovës, ku këto të drejta, më tej realizohen në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Ky ligj i garanton të drejtën e punës nëse një person është i kualifikuar dhe nëse ka punë në dispozicion. Mirëpo, nuk garanton të drejtën e punës në një pozitë specifike të punës.
32. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Gjykata gjeti se KPMK-ja, sipas ligjit, i shqyrtoi meritat e kërkesëpadisë së parashtrueses, me ç'rast e vërtetoi gjendjen faktike me rëndësi për nxjerrjen e vendimit të saj, duke përfshirë Aktvendimin C. nr. 752/07 e Gjykatës Komunale në Prishtinë, i cili lejon përmbarimin e vendimit të KPMK-së.
33. Gjykata konstaton se përmbarimi i Aktvendimit të Gjykatës Komunale, të cilin e konteston parashtruesja e kërkesës, në asnjë mënyrë nuk e pengon atë që të punojë të ushtrorë profesion apo të merr pagën e paraparë për vendin e punës. Për më tepër, me nënshkrimin e kontratës së punës më 23 shkurt 2009, parashtruesja në mënyrë specifike u pajtua që të transferohet nga një vend i punës në pozitë tjetër dhe pagë ekuivalente të përcaktuar në vendimin e KPMK-së, me çka u zbatua vendimi i KPMK-së nga MPMS-ja.
34. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asnjë bazë objektive që të mbështesë pretendimet e parashtrueses se Aktgjykimi i kontestuar i ka shkelur të drejtën e punës apo ushtrimit të profesionit të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës. Në fakt, me pajtimin e saj specifik për transferimin e pozicioneve më 29 shkurt 2009, parashtruesja ka arritur të gjitha të drejtat e saja të përcaktuara me nenin 49 të Kushtetutës.
35. Gjykata thekson se mospajtimi i parashtrueses me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005)).
36. Gjykata, më tej, rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih Rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
37. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesja nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.



Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 mars 2016, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Robert Carolan



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Arta Rama-Hajrizi